



REPUBLIKA E KOSOVËS - RITETI NA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLAHA KOVINA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH

Mr. Pred.
Mr. Prof.
Mr. Prof.
Mr. Prof.

10 - 05 - 926

9 - 04 06 26

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva- Ministry of Health

Inspektorati Farmaceutik/Farmaceutski Inspektorat/Pharmaceutcial Inspectorate

Raport		
Data/Date/Datum:	02.06.2026	Ref. No. 10/KT-005-26
Për/To/ Za:	Z. Nadir Çausholli, themelues i Barnatores " Cfo Green Njësia 39", Rruga: "Ismail Qemajli p.n", Vushtrri, Republika e Kosovës	
Përmes/Through/Preko:	Mr. Sc Remzie Thaçi, Drejtor i Departamentit të IF-së	
Nga/From/Od:	Mr.Ph. Kaltrina Topalli, Inspektore farmaceutike Mr.Ph. Adelina Surdulli, Inspektore farmaceutike	
Lënda/ Subject/Tema:	Raport i inspektimit për Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoren) "Cfo Green Njësia 39" Rruga: "Ismail Qemajli p.n", Vushtrri.	
Cc:	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë Z. Jahë Gecaj, UD Sekretar i Përgjithshëm i MSh-së Mr.Ph. Labinot Zeqiri, Kryeinspektor Qëndror Shëndetësor Mr.Ph. Arian Ahmeti, Zëvendësues i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në AKPPM	

I. Përmbledhja

Inspektorati Farmaceutik me datë 04.05.2026 ka kryer inspektim me ankesë/kërkesë në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoren) "Cfo Green Njësia 39", Rruga: "Ismail Qemajli p.n", Vushtrri.

Barnatorja u gjet e hapur duke operuar pa prezencë të farmacistes/farmacistit të licencuar.

Inspektim i bazuar në Ligjin për Shëndetësi 04/L-125, Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale 04/L-190, Udhëzimin Administrativ për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale 11/2015, Ligjin 05/L-087 për Kundërvajtje të Republikës së Kosovës, Ligjin 08/L-067 për Inspektimet.

Në fund të inspektimit u përpilua Procesverbali me numër serik 0110274, i cili i është lexuar Palës dhe është nënshkruar nga Pala prezente pa ndonjë pretendim apo vërejtje, si dhe nga Trupa Inspektuese.

Prezent gjatë inspektimit ishte Znj. Diellza Kamberi, teknike e farmacisë me numër të licencës KO-45587/A-05-4 dhe Znj. Arjana Ismaili, teknike e farmacisë me numër të licencës KO-51266/A-05-4.

II. Metodologjia

Metodat e shfrytëzuara gjatë inspektimit:

- **Intervistimi:** Bashkëbisedimi me Znj. Diellza Kamberi, teknike e farmacisë dhe Znj. Arjana Ismaili, teknike e farmacisë.
- **Mbledhja e fakteve:** Licenca e Barnatores, Certifikata e Biznesit, Licenca e Farmacistes Përgjegjëse, Licenca e Teknikës së Farmacisë
- **Observimi:** Gjatë inspektimit janë kontrolluar dokumentacioni, produktet dhe pajisjet medicinale si dhe prezenca e stafit profesional.

III. Faktet

Inspektorati Farmaceutik me datë 04.05.2026 ka kryer inspektim me ankesë/kërkesë me miratim dhe në bashkëpunim me Inspektoratin e Tregut në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoren) "Cfo Green Njësia 39", Rruga: "Ismail Qemajli p.n", Vushtrri.

Ankesa drejtuar IF-së kishte të bënte me dispensimin e produkteve medicinale që subjekti në fjalë kishte dizpenzuar produkte medicinale duke aplikuar zbritjen gjatë vikendeve (-5% rabat) tek produktet të cilat posedojnë banderolë dhe i nënshtrohen nivelizimit të çmimeve.

Gjatë inspektimit barnatorja u gjet e hapur, shërbimet farmaceutike ofroheshin nga teknikja e farmacisë Znj. Diellza Kamberi me numër të licencës së punës KO-45587/A-05-4. Në barnatore nuk ishte prezent farmacistja përgjegjëse Mr.Ph. Rozanë Spahiu me nr. të licencës 028/17 e as ndonjë farmacist/e zëvendësues/e.

Pas fillimit të inspektimit, pas një kohe në subjekt u paraqit farmacistja Mr.Ph. Gentianë Rama - Frustemi me nr. të licencës RKS-1295-22 e cila fillimisht nuk prezantoi ndonjë dokumentacion apo autorizim që dëshmonte angazhimin e saj si farmaciste zëvendësuese në barnatoren "Cfo Green Njësia Nr.39".

Më pas në praninë e Inspektoratit Farmaceutik farmacistja e lartëcekur e printoi një dokument me pretendimin se ky dokument paraqet autorizimin për prezencën e saj. Farmacistja në fjalë ka deklaruar se është farmaciste përgjegjëse në barnatoren "Cfo Green Njësia Nr.36" në Vushtrri.

Nga verifikimi i kuponit fiskal të datës 28.03.2026, i paraqitur në kuadër të ankesës, rezulton se janë dizpenzuar produkte medicinale që i nënshtrohen recetës së mjekut. Stafi i pranishëm nuk ka deklaruar se kush e ka bërë dispensimin e produkteve të paraqitura në kuponin fiskal.

Në kohën e inspektimit në barnatore prezent ishin dy tekniket e farmacisë: Znj Ariana Ismaili me nr.të licencës KO-51266/A-05-4 dhe Znj Diellza Kamberi me nr.të licencës KO-45587/A-05-4.

Përmes Procesverbalit me numër 0110274, Pala është urdhëruar të punoi sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

IV. Konstatimet

- Qarkulluesi Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatorja) "Cfo Green Njësia 39", Rruga: "Ismail Qemajli p.n", Vushtrri, e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), me Numër Unik Identifikues 810819162 dhe në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) me Numër të Licencës L5-0092/25/02/2025, me pronar Z. Nadir Çausholli dhe me farmacistë përgjegjëse Mr.Ph Rozanë Spahiu, me numër të licencës së punës 028/17, posedon licencë valide të veprimtarisë pranë AKPPM-së.
- Barnatorja u gjet e hapur, shërbimet farmaceutike ofroheshin nga teknika e farmacisë Znj. Diellza Kamberi me numër të licencës së punës KO-45587/A-05-4.
- Në kohën e inspektimit në barnatore nuk ishte prezent farmacistja përgjegjëse apo zëvendësuese, me ç'rast konstatohet se Pala ka vepruar në kundërshtim me nenin 14 (paragrafin 2) të Ligjit 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që përcakton: *"Barnatorja duhet të ketë gjatë gjithë orarit të punës farmacist/farmacistet e licencuar."*, nenin 26 (paragrafin 2) të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, që përcakton: *"Barërat e përshkruara nga mjeku ose stomatologu mund të jepen vetëm nga ose në prezencën e farmacistit të licencuar."*, nenin 6 (paragrafët 3 dhe 4) të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që përcakton: *"Barnatorja mund të funksionojë vetëm në prezencë të farmacistit."* dhe *"Në rast kur farmacisti nuk mund të jetë prezent në barnatore, bartësi i licencës profesionale të barnatores është i obliguar që ta angazhojë farmacistin zëvendësues, i cili autorizohet për kryerjen e detyrave të farmacistit"*.
- Farmacistja Mr.Ph. Gentianë Rama-Rrustemi pas paraqitjes në subjekt me vonesë konkretisht pas hyrjes së Inspektorëve Farmaceutik, e njëjta në fillim nuk ka prezantuar ndonjë dokument/autorizim si dëshmi se është farmacistë zëvendësuese. Ndërkohë në praninë e IF-së ka printuar një dokument me pretendimin se ky dokument paraqet autorizimin për prezencën e saj por që i njëjti përmban shumë mangësi respektivisht nuk e përmban periudhën kohore për kryerjen e detyrave në mungesë të farmacistit përgjegjës si dhe disa nga rubrikat janë plotësuar manualisht.
- Nga verifikimi I kuponit fiskal të datës 28.03.2026 rezulton dispensimi I produkteve medicinale që I nënshtrohen recetës së mjekut, stafi prezent në barnatore nuk ka deklaruar se kush e ka bërë dispenzimin e produkteve të prezantuara në kupon fiskal.

V. Rekomandimet

- Urdhërohet që në barnatore të operohet vetëm sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- Raportin e shoqëron Vendimi me gjobë numër 10/KT-005-26.
- Për plotësimin e rekomandimeve Pala të njoftojë me shkrim Inspektoratin Farmaceutik.

Raportit i bashkangjitet :

Kopja e Procesverbalit me numër serik 0110274 dhe foto dëshmitë e dokumenteve në fjalë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarsitvo Zdravstva-Ministry of Health

Inspektorati FARMACEUTIK

0110274

(Nr. Serik)

PROCESVERBAL I INSPEKTIMIT

04.05.2025
(Data e fillimit të inspektimit)10:00
(Ora e fillimit të inspektimit)Në subjektin: BARNATORE, CEO GREEN NJ: 39 - L5-0092125/0212025
ARBK: 810819462 (Emërtimi i subjektit të inspektimit)I udhëhequr nga: Z. NADIR ÇAUHOLLI - PRONAR, FARMACISTE PËRGJEGJËSE
NR. P. P. ROZANË SPAHIU
(Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të subjektit të inspektimit) 028117Në adresën: RR. HA ISMAIL GEMAJLI
(Adresa e subjektit të inspektimit)

Inspektimi është realizuar nga:

MR. P. KALTRINA TOPALLI
MR. P. ADELINA SURDULLI
AFRIM FATA - IT
(Emrat dhe mbiemrat e inspektorëve dhe
personave të autorizuar për inspektim)
AFRIM GASHI - IT

it:

117-1097
328(Numri përkatës i dokumentit të
identifikimit të inspektorit dhe të
personave të autorizuar)Në informatat kontaktuese: KALTRINA TOPALLI @EKS-GOV.NE
(Adresa elektronike e njërit nga inspektorët dhe numri zyrtar kontaktues)Baza ligjore e inspektimit: LIGJI 041/L-190; LIGJI 041/L-125; LIGJI 031/L-067Procesverbali përpilohet për: INSPEKTIM ME ANKESË / KËRKESË
(Lloji i inspektimit)Inspektimi është bërë: me miratim ☒ pa miratim ☐Inspektimi është bërë pa miratim përshkak të: /
(Arsyeja e inspektimit pa miratim)Pranimi i miratimit të inspektimit është refuzuar nga subjekti i inspektimit: po ☐ jo ☒Ka munguar personi përfaqësues i subjektit të inspektimit: po ☒ jo ☐Miratimi i inspektimit është vendosur fizikisht aty ku është kryer inspektimi: po ☐ jo ☒

Arsyeja për devijimin e inspektimit nga lista e kontrollit të inspektimit është:

CFO PHARMA SHPK-CFOGreen

Qarkullimi i Mallit

NUJ:810819162

Maqistralja Prishtine-Ferizaj, km. 7
+383 49 763 001

Prej: 04-05-2026

Deri: 04-05-2026

Nr.	Shifra / Barkodi Artikulli	Fatura nr.	Sasia	Rebat	Cmimi	Vlera	Ora
1	12602 ALW-PLATINUM-ULT-SUPER-PLUS (2)	12911	1	5.00	€ 2.28	€ 2.28	7:11
2	9122 CITRAM TBL 10MG A 28	12912	1	0.00	€ 4.46	€ 4.46	8:24
3	28657 CLOPIDOGREL AUROVITAS 75MG A2	12913	1	0.00	€ 4.09	€ 4.09	8:34
4	5034 FENKAROL TBL 25 MG A 20	12914	1	0.00	€ 8.18	€ 8.18	8:38
5	32966 PANTENOL UNG 30G	12914	1	0.00	€ 2.90	€ 2.90	8:38
6	11850 SOLTUX SIR 100ML	12915	1	0.00	€ 4.80	€ 4.80	9:02
7	4128 2013-02 (2104) HIPPI 1 COMBIOTIC 800	12916	1	0.00	€ 20.90	€ 20.90	9:10
8	35979 SEPTURO CPS A30	12917	1	0.00	€ 9.80	€ 9.80	9:11
9	12881 FLOXEDOL EYE DROPS 10ML	12918	1	0.00	€ 5.80	€ 5.80	9:19

17	1613	AMPRIIL HD 5MG/25MG TAB 28	2924	0.00	€ 3.19	€ 3.19	9.34
16	2854	BUSCOPAN DRAZHE 20X10MG	1297	10.00	€ 4.87	€ 4.87	9.33
15	32624	CONVER DE TBL 30X300/25MG	18922	0.00	€ 10.52	€ 10.52	9.30
14	1563	VALOSIDEN FORTE CRS 420	18911	5.00	€ 5.20	€ 5.20	9.29
13	35305	ZINACOL 100MG X 30CRS	12940	0.00	€ 5.28	€ 5.28	9.28
12	1615	BRONCOBALSTABLA SR 200ML	18910	0.00	€ 9.50	€ 9.50	9.26
11	327	QUINOLIN 100/25MG X 20	2924	0.00	€ 4.76	€ 4.76	9.26
10	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	5.00	€ 18.50	€ 18.50	9.24
9	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 5.34	€ 5.34	9.1
8	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 5.50	€ 5.50	9.11
7	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 4.90	€ 4.90	9.10
6	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 4.90	€ 4.90	9.10
5	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 4.90	€ 4.90	9.10
4	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 4.90	€ 4.90	9.10
3	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 4.90	€ 4.90	9.10
2	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 4.90	€ 4.90	9.10
1	327	COXINOL 100/25MG X 20	32613	0.00	€ 4.90	€ 4.90	9.10

AUTORIZIM

qyterin e Vëshirimit

Licences 1198 - 1245 - 22

Farmacisti/ja në fjalë, gjatë kësaj periudhe, është e autorizuar për detyrimet dhe përgjegjësit brenda barnatorës, siç orënim i barit sipas recetës, kontrollimi i mirëmbajtjes së barnave në barnatore, si dhe të zbatoj udhëzimet administrative dhe ligjet të përcaktuara nga Ministria e shëndetësisë dhe AKPPM-ja që kërkohen një farmacisti të licencuar, i cili punon në Barnatore Komunitare.

Nënshkrimi

Wycena Nr.39

Mr. Ph

Nënshkrimi

E përpiluar nga